



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR
DREJTORIA EKONOMIKE DHE CESHTJEVE SOCIALE
SEKTORI I SHERBIMIT SOCIAL

Nr. 256 prot.

Ballsh, më 19.01.2026

PROJEKT- VENDIM

Nr. 01, datë 19 / 01 / 2026

PER MIRATIMIN KRITEREVE PER FAMILJET NE NEVOJE QE DO TRAJTOHEN ME NDIHME EKONOMIKE DERI NE 6 % TE FONDIT TE KUSHTEZUAR PER BLOK-NDIHMEN ME FONDET E PUSHTETIT QENDROR DHE VENDOR PER VITIN 2026.

KESHILLIT TE BASHKISE MALLAKASTER

Ne mbështetje te Ligjin nr. 139/2015 "Per vetqeverisjen vendore", Ligjit Nr. 9936 date 26/06/2008 "Per mcnaxhinin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqiperise", i ndryshuar, Ligjin Nr 109/2017, Ligjit Nr 57/2019 "Per asistencen sociale ne Republikën e Shqiperise", Neni 21 "Roli i Keshillit Bashkiak", VKM Nr. 597 date 04/09/2019 "Per percaktimin e procedurave te dokumentacionit dhe mases mujore e perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike", Kapitulli IV "Perdorimi i fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike" : VKM Nr 868, date 29/12/2021, Për disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr 597, Date 04.09.2019, të Keshillit Te Ministrave" Per percaktimin e procedurave te dokumentacionit dhe mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike "si dhe Udhezimet,e Ministrise se Shendetesise dhe Mireqenies Sociale per bllokndihmen ekonomike deri 6 %,me fondet e buxhetit qendror dhe vendor,Drejtoria Ekonomike dhe Ceshjeve Sociaie:

PROPOZOJ:

Miratimin e kritereve per familjet ne nevoje,qe do trajtohen me ndihme ekonomike deri ne 6 %,te fondit te kushtezuar per bllok-ndihmen ekonomike,si dhe ato qe do trajtohen me fondet e buxhetit vendor , si me poshte vijon ;

Kriteret per perfituesit nga programi I bllok-ndihmes 6 % nga fondi I kushtezuar dhe me fondet e buxhetit vendor :

- ❖ Familjet te cilat kane aplikuar per ndihme ekonomike,brenda tre muajeve dhe nuk jane perzgjedhur fituese nga sistemi i pikezimit.
- ❖ Familjet te cilat perzgjidhen per tu trajtuar me kete fonde duhet te jene te verifikuara paraprakisht nga Administratori shoqeror.
- ❖ Familjet e perzgjedhura duhet te jene familje ne nevoje,pa te ardhura ose me te ardhura te pamjaftueshme.
- ❖ Familje me Kryefamiljar/e, burra/ gra(vajza nena/ burra baba , te ve/ja, te divorcuar/a),me te pakten nje femije: te mitur, qe ndjek arsimin baze ose te larte.
- ❖ Familje kur K/familjari ose antare te familjes,qe jane te paafte per te punuar ,por per shkak te legjislacionit ne fuqi nuk perfitojne pagesa P.A.K.
- ❖ Femije jetim ne ose nen moshe,te moshuar dhe individe te vetmuar,pa te ardhura ose te ardhura te pamjaftueshme.
- ❖ Familje qe kene femije ne moshe madhore,por qe kane probleme te ndryshme sociale, te cilet kane veshtiresi punesimi.
- ❖ Familje me shume femijë.

Drejtoria Ekonomike dhe Ceshtjeve Sociale,do te propozoje cdo muaj numrin e familjeve per cdo Njesi ne baze te fondit te disponueshem.

Pergjegjesi i Sektorit te Sherbimit Social

Kleidja Hoxhaj

Drejtori Ekonomik

Aleksander Rama

Drejtori Juridik

KRYETAR

Qerim ISMAILAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
DREJTORIA EKONOMIKE DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 206 / prot.

Ballsh, më 19 / 01 .2026

KESHILLIT TE BASHKISE MALLAKASTER
RELACION SHPJEGUES PER FAMILJET NE NEVOJE QE DO TE TRAJTOHEN
ME NDIHME EKONOMIKE DERI NE 6% TE FONDIT TE KUSHTEZUAR DHE
NGA FONDET E BUXHETIT TE BASHKISE

Me mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015“ Per veteqeverisjen vendore“,neni 8 pika 2,neni 9,neni 24,Ligjit Nr 936 date 26/06/2008”Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqiperise”i ndryshuar me Ligjin Nr 109/2017;Ligjit Nr. 57/2019”Per Asistencen Sociale ne Republikën e Shqiperise“,Neni 21”Roli i Keshillit Bashkiak” Keshilli bashkiak miraton kriteret per dhenien e ndihmes ekonomike per familjet aplikuese qe nuk jane shpallur fituese nga sistemi i pikezimit, bashuar ne vleresimin social-ekonomik te kryer nga administratori shoqeror.

Familjet ne nevoje trajtohen nga fondi shtese mbi fondin e kushteziuar per ndihmen ekonomike, duke perfshire ose jo dhe fonde te buxhetit vendor, po ju relatojme, kategorite qe do te trajtohen. Per ti ardhur ne ndihme kategorive sociale ne kushte ekstremisht ne nevoje, pa te ardhura ose te ardhura te pamjaftueshme, te cilat kane aplikuar per ndihme ekonomike brenda tre muajve dhe nuk kane perzgjedhur fitues nga sistemi i pikezimit, hartuam kriteret per trajtimin nga 6% i buxhetit te kushteziuar dhe buxheti i bashkise me status si vijon:

- ❖ Familje me Kryefamiljar/e, burra/ gra (vajza, nena/ burra,baba, te ve/ja, te divorcuar/a)me te pakten nje femije: te mitur, qe ndjek arsimin baze ose te larte, ndare nga jeta K/familjari ose anetare te familjes.
- ❖ Familje kur K/familjari ose anetare te familjes qe jane te paafte per te punuar, por per shkak te Legjislacionit ne fuqi nuk perfitojne pagesa P.A.K., jane familje ne varferi ekstreme, te cilat kane ne perberje anetare te paafte per pune.

- ❖ Femije jetim ne ose nen moshe, të moshuar dhe invalide te vetmuar, pa te ardhura ose te ardhura te pamjaftueshme , te cilet nuk perfitojne nga programet e tjera sociale si, pensione etj.
- ❖ Familje qe kane femije ne moshe madhore, por qe kane probleme te ndryshme sociale(perdorues te lendeve narkotike, probleme me ligjin etj) te cilet kane veshtiresi punesimi qe nuk ndodhen ne qendra komunitare.
- ❖ Familje me shume femije, familje qe kane me shume se tre femije, por qe nuk perfitojne nga programet sociale.

Per te gjitha familjet ose individet, zbatohen Udhezimet e Ministrise se Shendetesise dhe Mireqenies Sociale per bllokndihmen ekonomike deri ne 6% si per strukturen e familjes dhe masen e ndihmes ekonomike.

Ju falenderojme per bashkepunimin.

P/S Sherbimit Social
Kleidja Hoxhaj

Drejtori Ekonomik
Aleksander Rama

Drejtori Juridik

KRYETAR
Qerim ISMAILAJ

